



## **SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS**

Datë, 13/05/2026

### **KËRKESË**

**Kërkues:** Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, me nipt K42407012T, me adresë Rruga “Llazi Miho” Nd. 6, Sh. 1, Kat 1, Kombinat, Tiranë.

Të dhënat elektronike të kontaktit (neni 154/2/a i KPC) Tel: **068 4030111**

**LËNDA:** Kërkesë për zgjatjen e afatit të zbatimit të VKM-së “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës në kushtet e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”.

#### **DREJTUAR: KRYEMINISTRISË**

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

*Z.Ervin DEMO*

#### **BASHKISË TIRANË**

Kryetar

*Zj.Anuela RISTANI*

Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike

*Z.Enton PUNAVIJA*

#### **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

*Z.Enea KARAKACI*

#### **MINSITRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

*Z.Petrit MALAJ*

#### **MINSITRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT**

*Zj,Delina IBRAHIMAJ*



## SHOQATA KOMBËTARE E TRANSPORTIT QYTETAS

**Të nderuar,**

Shoqata e Transportit Publik Qytetas, në përfaqësim të operatorëve të transportit publik qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, duke iu referuar projektvendimit/VKM-së “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas në kushtet e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”, paraqet kërkesën për zgjatjen e afatit të zbatimit të kësaj mase mbështetëse edhe për një periudhë shtesë prej 3 (tre) muajsh.

Referuar përmbajtjes së aktit të sipërcituar, vetë Këshilli i Ministrave ka pranuar ekzistencën e një situatë të veçantë në tregun e hidrokarbureve, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostove të ushtrimit të aktivitetit të transportit publik. Aktualisht, kjo situatë jo vetëm që vazhdon të jetë prezente, por çmimet e karburantit vijnë të mbeten në nivele të larta dhe me ndikim të konsiderueshëm financiar për operatorët e sektorit. Në kushtet kur karburanti përbën një nga kostot kryesore të aktivitetit të transportit publik, vazhdimësia e çmimeve të larta ka sjellë rëndim të ndjeshëm të barrës ekonomike për subjektet transportuese, duke vështirësuar përmbushjen e detyrimeve financiare dhe garantimin e vazhdimësisë normale të shërbimit publik ndaj qytetarëve.

Në zbatim të parimeve të proporcionalitetit, vazhdimësisë së shërbimit publik dhe mbrojtjes së interesit publik, vlerësojmë se ekzistojnë ende kushtet objektive dhe ekonomike që justifikojnë vijimin e masës kompensuese të parashikuar në VKM, për aq kohë sa situata në tregun e hidrokarbureve nuk është stabilizuar. Kështu, kërkojmë marrjen e masave për zgjatjen e afatit të kompensimit financiar në masën 50 lekë/litër karburant edhe për periudhën korrik – shtator 2026, duke vijuar me të njëjtat procedura, kritere dhe dokumentacion të përcaktuar në aktin normativ në fuqi. Gjithashtu, vlerësojmë se vazhdimi i kësaj mase mbështetëse është i domosdoshëm për të garantuar vijimësinë dhe stabilitetin e shërbimit të transportit publik; shmangien e reduktimit të flotës dhe frekuencave të shërbimit; mbrojtjen e interesit qytetar dhe përballueshmërinë e transportit publik; ruajtjen e balancës financiare të operatorëve të licencuar të sektorit.

Në pritje të një vlerësimi pozitiv të kësaj kërkesë dhe marrjes së masave përkatëse institucionale, ju falënderojmë për bashkëpunimin.

**Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas**

**KRYETAR**

**Kostandin Foni**

*Kostandin Foni*



*Foni*